**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

Nr. 4766 Prot Peshkopi, më 14.10.2022

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për dijeni Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.90**

**Datë: 11.10.2022**

**"Për ngritjen e një komisioni inspektimi për situatën në Kopshte dhe Çerdhe"**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Afrim Mikli**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**VENDIM**

**Nr. 90 Datë 11/10/2022**

**"Për ngritjen e një komisioni inspektimi për situatën në kopshte dhe çerdhe"**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit", gërma a, mbështetur në shqetësimet e prindërve në dëgjesën publike të mbajtur në 07.10.2022, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 11.10.2022, me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ngritjen e një komisioni me 5 anëtarë për inspektimin e situatës në kopsht dhe cerdhe:

2. Komisioni inspektimit:
   a. Astrit Ademi
   b. Eligerta Xheka
   c. Erisa Degjoni
   d. Atli Qoka
   e. Alketa Çanaku

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak Dibër.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar Këshilli**
**Sokol Sava**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

4766/1 29/10/22

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**PREFEKTI I QARKUT DIBËR**

Nr.1007/1.prot.

Peshkopi, më 18.10.2022

Lënda : Per vendimin nr. 90, datë 11.10.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.90, date 11.10.2022 "Për ngritjen e një komisionin për situatën në Kopshte dhe Çerdhe", konstatova se:

Vendimi objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e tij, veprim që kurdoherë bëhet nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturës së posaçme të Bashkisë Dibër që ka paraqitur për miratim një projekt - akt të kësaj natyre.

Hyrja në fuqi e akteve administrative të karakterit individual , sikurse shpreheni në pikën 4 të dispozitivit të këtij vendimi hyn në fuqi menjëherë.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU